



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PËRKTHIM B-A**

Ngarkesa: 6kredite; 60orë mësimore; 20 leksione /40seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet Semestri II Viti I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “Përkthim B -A” është një lëndë e karakterit kryesisht praktik. Në të do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm teknik duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmbledhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore C-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe refleksat redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre, do mund të njohin terminologjinë në dy fusha të rëndësishme, si ajo juridike dhe ekonomike.